

Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm, të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas nenit 68 paragrafi 5 nga Rregullorja gjyqësore dhe nenit 41 të Rregullores së punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 25.10.2021, nxori konkluzionet në vijim lidhur me aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Sinadinovska kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.27881/06 të datës 16 janar të vitit 2020:

### **KONKLUZION**

**Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Sinadinovska kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut A.nr.27881/06 të datës 16 janar të vitit 2020 do të paraqes vendim referent, në të cilin kjo gjykatë do të thërritet dhe do ta citojë çdoherë, kur do të vendos për lëndë, të cilat janë të ngjashme me rastin e Sinadinovskës kundër RMV.**

### **KONKLUZION**

**Në raste kur përsëri parashtrohet kërkesë për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm nga i njëjti parashtrues dhe për të njëjtën procedurë gjyqësore që është ende në rrjedhë, periudha juridike relevante do të përcaktohet llogaritur nga akti iniciues, vetëm në qoftë se paraprakisht kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm ka qenë e refuzuar si e pa bazë.**

### **KONKLUZION**

**Përmbarimi i aktgjykimit të plotfuqishëm për shkak të realizimit të së drejtës së konstatuar gjyqësore është pjesë përbërëse e procedurës iniciuese civile dhe periudhës juridike relevante çdoherë do të përcaktohet llogaritur nga ngritja e procedurës civile.**

### **KONKLUZION**

**Gjatë vendimmarrjes për kërkesën e parashtruar për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, lëndë vlerësimi do të jetë edhe kohëzgjatja e procedurës së zhvilluar me rastin e ndonjë mjeti të jashtëzakonshëm efikas në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.**

**SEKTORI PËR GJYKIM NË AFAT TË ARSYESHËM**